

Rr. Naum Naumovski Borçe 83/1
1000, Shkup

Tel. +389 (0)2 3119 073
Faksi +389 (0)2 3290 469
Cel. +389 (0)78 252 812
helkom@mhc.org.mk
www.mhc.org.mk

MISIONI DHE VIZIONI

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i Republikës së Maqedonisë është një shoqatë e qytetarëve e regjistruar në vitin 1994. Organet e Komitetit të Helsinkit janë:

- Kuvendi,
- Bordi Drejtues,
- Kryetari,
- Bordi Mbikëqyrës dhe
- Zyra Ekzekutive.

Komiteti kryen monitorimin e gjendjes së të drejtave të njeriut, siguron ndihmë juridike, bashkëpunon me organizata tjera dhe me organet shtetërore në kuptimin e rritjes së promovimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

Objektivi i Komitetit është mbrojtja dhe avancimi i të drejtave dhe lirive të njeriut, të garantuara me Kushtetutën e RM-së, instrumentet ndërkombëtare dhe Dokumentin Përfundimtar të Helsinkit të vitit 1975, dhe ndërtimi i kushteve demokratike brenda të të cilave ato mund të ushtrohen në bazë të sundimit të ligjit.

Komiteti nisat nga fakti se të gjithë njerëzit duhet patur mundësinë e gëzimit dhe ushtrimit të të drejtave dhe lirive bazë të tyre dhe duhet patur mundësinë e mbrojtjes në rast të shkeljes ose kufizimit të tyre. Kjo gjë paraqet bazën e sundimit të ligjit, të të drejtave të njeriut dhe të demokracisë.

AKTIVITETET

Në përpjekjet që bën për avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe për harmonizimin e legjislacionit dhe praktikës së brendshme me atë të Bashkimit Evropian, Komiteti i Helsinkit:

- Organizon vëzhgimin sistemik të gjendjeve të të drejtave të njeriut në vend;
- Siguron ndihmë juridike falas dhe mbron të drejtat individuale, kolektive, si dhe të drejtat e subjekteve tjera juridike në territorin e Republikës së Maqedonisë edhe përpara organizatave ndërkombëtare;
- Përpilon raporte mujore, vjetore dhe të posaçme mbi gjendjen e të drejtave të njeriut;
- Zhvillon analiza dhe dokumente tjera profesioniste lidhur me gjendjen e të drejtave të njeriut;
- Organizon konferenca, seminare, forume, si dhe aksione tjera dhe forma ligjore të aktivitetit qytetar;
- Promovon dhe ndihmon zhvillimin e demokracisë, sundimit të ligjit dhe shoqërisë civile, dhe
- Kryen punë tjera të interesit publik në pajtim me Ligjin e Shoqatave të Qytetarëve.

NDIHMJA JURIDIKE FALAS

Komiteti i Helsinkit siguron ndihmë juridike në fushat në vijim:

- Mbrojtja nga diskriminimi
- E drejta e jetës
- E drejta nga torturimi dhe keqtrajtimi
- Mbrojtja nga deprivimi i paligjshëm nga liria
- E drejta e mbrojtjes sociale
- Të drejtat e personave me çrregullime fizike, mendore, intelektuale ose shqisore
- Barazia midis burrave dhe grave
- E drejta e konfesionit fetar
- Liria e të folurit dhe informimit
- Mbrojtja e të dhënave personale dhe privatësisë
- Liria e bashkimit dhe protestës
- Liria e lëvizjes
- E drejta e mbrojtjes shëndetësore
- E drejta e fëmijëve dhe të rinjve
- E drejta e arsimit
- E drejta e pjesëtarëve të komuniteteve
- Mbrojtja nga dhuna në familje
- E drejta e gjykimit të drejtë në afat të arsyeshëm
- E drejta e azilit
- Të drejtat lidhur me zgjedhjet

Komiteti i Helsinkit nuk siguron ndihmë juridike në fushat në vijim:

- E drejta e pronës (me përjashtim të rasteve kur shkelja është bërë nga shteti)
- E drejta e punësimit dhe punës (me përjashtim të rasteve të diskriminimit dhe mobingut)
- Detyrimet financiare (me përjashtim të parregullësive evidente ose të rrezikimit të mbrojtjes sociale)
- Mbrojtja e familjes (me përjashtim të rasteve të dhunës në familje dhe shkeljes së të drejtave të fëmijës)
- Marrëdhëniet kontraktuese midis personave fizikë dhe juridikë (me përjashtim të rasteve kur shkelja është bërë nga shteti)
- Të drejtat e autorit dhe pronësisë industriale
- Procedurat e falimentimit
- Sigurimi pensional dhe invalidor (me përjashtim të rasteve kur shkelja e të drejtave është bërë nga shteti)
- Kundërvajtjet (me përjashtim të rasteve kur shkelja është bërë nga shteti)
- Të drejtat dhe obligimet e partive politike
- Të drejtat dhe obligimet në vende të huaja
- Të drejtat e komunitetit LGBTI

SI DERI TEK NDIHMJA FALAS JURIDIKE?

Komiteti i Helsinkit është shoqatë e autorizuar për dhënie të ndihmës juridike, e regjistruar në Regjistrin Shtetëror të Dhënësve të Ndhmës Juridike Paraprake.

Në qoftë se keni nevojë për ndonjë këshillë juridike, mund të paraqiteni në numrin e telefonit falas: **0800 44 222**

Në rast se pas bisedës keni nevojë për ndihmë juridike plotësuese, mund të shkarkoni dhe të plotësoni një Kërkesë për Ndhmë Falas Juridike nga ueb faqja jonë – www.mhc.org.mk, si dhe të drejtoheni në zyrën tonë. Së bashku me Kërkesën, dërgoni dhe kopje të dokumenteve që kanë të bëjnë me lëndën Tuaj. Nëse nuk jeni në mundësi të bëni fotokopje, këtë do ta bëjmë ne në zyrën tonë.

Pas dërgimit të Kërkesës me postë, postë elektronike, ose pas parashtrimit të saj në zyrën tonë, do t'u caktohet një këshilltar juridik, i cili do të punojë në lëndën Tuaj. Varësisht nga lënda dhe nëse jeni dakord, Komiteti i Helsinkit mund të sigurojë këshillim, mbështetje dhe përfaqësim përpara organeve shtetërore, si dhe informim të publikut të gjerë në rastet e shkeljeve të rënda të të drejtave.



Rr. Naum Naumovski Borçe 83/2
1000, Shkup

Tel. +389 (0)2 3256 174
Faksi +389 (0)2 3290 469
info@lgbti.mk
www.lgbti.mk

VIZIONI DHE MISIONI

Qendra LGBTI për Mbështetje është themeluar më 23 tetor të vitit 2012, si degë e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut.

Vizioni i Qendrës LGBTI për Mbështetje është një shoqëri e liruar nga diskriminimi, brenda së cilës të gjithë njerëzit gëzojnë të drejtat dhe liritë universale të njeriut, pavarësisht nga orientimi seksual, identiteti gjinor, ose nga cilësdo veçori tjetër.

Misioni i Qendrës LGBTI për Mbështetje është fuqizimi i komunitetit LGBTI për vetëpërfaqësim, si dhe ndryshimi i statusit juridik dhe social i personave LGBTI në Republikën e Maqedonisë.

Vlerat e Qendrës LGBTI për Mbështetje pushojnë mbi diversitetin, barazinë dhe lirinë. Në esencën e veprimit tonë janë rrënjësor universaliteti, solidariteti dhe paqa.

PËRSE EKZISTON QENDRA LGBTI

- Mbështetja e personave LGBTI
- Fuqizimi i komunitetit LGBTI
- Çrrënjësja e stereotipeve dhe paragjytimeve në shoqëri
- Promovimi, mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të personave LGBTI
- Ndryshimi i statusit social dhe juridik i personave LGBTI në Maqedoni
- Rritja e dukshmërisë së komunitetit LGBTI
- Sensibilizimi i institucioneve kompetente dhe i opinionit publik
- Rezistenca e koncepteve patriarkale dhe heteronormative
- Fuqizimi i kapaciteteve të popullatës LGBTI për vetëpërfaqësim
- Monitorimi i legjislacionit ekzistues, aplikimi dhe praktika e tij
- Ndërtimi i rrjeteve të organizatave, grupeve joformale dhe aktivistëve në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar

SHËRBIMET QË OFRON QENDRA LGBTI

- ☑ Ndhma juridike falas
- ☑ Mbështetja psiko-sociale e personave LGBTI
- ☑ Monitorimi, raportimi, përfaqësimi dhe lobimi përpara institucioneve të brendshme dhe ndërkombëtare
- ☑ Organizimi i grupeve të mbështetjes
- ☑ Organizimi i aktiviteteve shoqërore
- ☑ Sigurimi i qëndrimit për personat LGBTI që janë viktima të dhunës dhe diskriminimit
- ☑ Organizimi i trajnimeve, debateve dhe seminareve

KU TË DREJTOHENI PËR NDIHMË?

Në zyrën e Qendrës LGBTI/Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut

Ose në linjen telefonike falas **0800 666 66**